



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/52
Datë: 14.12.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 dhjetor 2011, mori:

V E N D I M

1. Themelohet Bordi për Menaxhimin e Pyjeve në kuadër të kabinetit të Ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për të zbatuar politikat, strategjitë dhe planet e veprimit të aprovuara nga Qeveria e Kosovës në këtë përbërje:
 - 1.1. Përfaqësues, Fakulteti i Shkencave Pyjore, Kryesues;
 - 1.2. Përfaqësues, Sekretar i Përgjithshëm i MBPZHR, anëtar;
 - 1.3. Përfaqësues, Sekretar i Përgjithshëm i MEF, anëtar;
 - 1.4. Përfaqësues, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH, anëtar;
 - 1.5. Përfaqësues, Sekretar i Përgjithshëm i MASHT, anëtar;
 - 1.6. Përfaqësues, Kryetar i Asociacionit të Pyjeve Private, anëtar;
 - 1.7. Përfaqësues, Kryetar i Asociacionit të Komunave, anëtar.
2. Në rolin këshillëdhënës pa të drejtë vote, caktohen dy anëtarë nga komuniteti i donatorëve (një përfaqësues nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe një përfaqësues nga Bashkimi Evropian).
3. Bordi bën mbikëqyrjen dhe koordinimin e zbatimit të planeve operacionale dhe Strategjisë së Pylltarisë, për vitin 2010-2020, si dhe aktiviteteve tjera.
4. Kryesuesi drejton mbledhjet e Bordit për Menaxhim dhe përfaqëson atë i cili sipas rregullit takohet së paku katër (4) herë brenda vitit, duke ju përmbajtur agjendës së punës, si dhe merr vendim me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve.
5. Bordi për Menaxhim nga pika 1 e këtij vendimi, ka për detyrë të:

